



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 05 - 23 nëntor 2018.
2. Miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektbuxhetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që lidhen me të.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Roven Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Alma Mehmeti - Shefe e Sektorit Juridik

Silvana Dervishi - Përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme

Armand Skapi - Përfaqësues i Ministrisë së Jashtme

Ilir Halilaj - Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Pjerin Shoshi -Drejtor i Programeve te Zhvillimit te Bujqësisë, Sigurisë
Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango - Drejtore Juridike

Elma Vathi - Shefe e Sektorit të Koordinimit dhe Integritetit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja –Përsëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës. Shpresoj të jetë një javë e mbarë për të gjithë kolegët në komision!

Ky do të jetë një muaj shumë i ngarkuar për shkak se nga dita e nesërme edhe në komisionin tonë do të nisë diskutimi i projektbuxhetit për vitin 2019 dhe i projektligjeve që lidhen me të.

Fillojmë pa humbur kohë me pikat që kemi në rendin e ditës. Pika e parë është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 05 - 23 nëntor 2018. Jeni dakord me kalendarin?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Kemi dy draftkalendarë, duhet të përmbledhen në një, sepse shikoj se në kalendarin e përgjithshëm, përveç kalendarit për projektbuxhetin për ditën e martë në datën 6 nëntor, për shembull është harruar të vendoset ajo që është caktuar për ditën e martë, shqyrtimi në parim i projektbuxhetit në orën 12:00. Drafti tjetër, se kemi dy përpara...

Ulsi Manja - Po, duhet të integrohet në draftin e kalendarit të datës 05-deri në 23 nëntor? Shumë dakord.

Bashkim Fino - Që të jemi në rregull.

Ulsi Manja - Propozimi i kolegut Fino është që të kemi një kalendar të integruar edhe me kalendarin e projektbuxhetit të vitit 2019.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, lidhur me ditën e nesërme është njoftuar se do të ketë seancë plenare në orën 10:00, ndërkohë që është planifikuar edhe mbledhja e komisionit në orën 10:00. Kuvendi ka edhe një aktivitet në orën 12:30, ku do të jenë të gjithë deputetët e Kuvendit. Kur do ta riskedulojmë mbledhjen e nesërme të Komisionit të Ligjeve?

Ulsi Manja – Është një shqetësim i lidhur me orarin e mbledhjes së komisionit për ditën e nesërme, i cili qëndron, por ne do ta riskedulojmë dhe nesër do të ketë mbledhje komisioni.

Parimisht nesër do të ketë mbledhje të komisionit, në cilëndo orë të zhvendoset orari, sepse duhet të përmbyllen projektligjet e reformës në drejtësi. Nesër është ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një projektligj që duhet të marrë vëmendjen dhe kohën e duhur nga kolegët, sepse është i rëndësishëm.

Bashkim Fino - Meqenëse jam relator për buxhetin dhe meqenëse ministri i Financave vjen nesër këtu në orën 12:00, normalsiht duhet të jetë ministri i Financave, nuk e di ndoshta mund ta zhvillojmë mbledhjen me ndërprerje, mund të fillojmë mbledhjen në orën 10:30 ose 11:00 pas seancës të fillojmë menjëherë me projektligjet që thotë nënkryetarja, por pastaj mund ta ndërpresim dhe të vazhdojmë me ministrin. Pastaj të vazhdojmë më tej, por pjesën e buxhetit, jo se e kam merak, por ngaqë do të vijë ministri të mos kemi probleme me orarin.

Ulsi Manja - Shumë faleminderit, zoti Fino!

Kjo është arsyeja pse do të miratojmë dy kalendarë dhe buxhetin e kemi në kalendar të veçantë.

Sekretaria e komisionit është në komunikim të vazhdueshëm me zyrën e ministrit të Financave për të përcaktuar orën e saktë se kur do të jetë i pranishëm zoti Ahmetaj për prezantimin në parim të projektbuxhetit.

Jeni dakord me kalendarin e punës së komisionit për periudhën 05-23 nëntor, me sugjerimet e kolegut Fino?

Miratohet.

Pika e dytë është miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektbuxhetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që lidhen me të. Është kalendar i veçantë për projektbuxhetin dhe për projektligjet, por që do të integrohen me kalendarin e punës së komisionit për datën 05-23 nëntor. Jeni dakord me kalendarin për projektbuxhetin?

Miratohet.

Pika e tretë është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të

vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Edmond Leka.

Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë paraqitur në komision: zoti Ilir Halilaj, zëvendësministër, zoti Pjerin Shoshi, drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, zonja Edlira Llango, drejtore Juridike, si dhe zonja Elma Vathi, shefe e Sektorit të Koordinimit dhe Integritetit.

Mirë se keni ardhur sot në komision, zoti zëvendësministër së bashku me stafin!

Do t’ju lutesha të bënit një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje për kolegët e komisionit. Më pas do t’ia kaloj fjalën kolegut, relatorit Leka.

Fjala është për ju.

Ilir Halilaj – Përshëndetje, të gjithëve!

I nderuar kryetar i Komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Jemi këtu për të kërkuar mbështetjen tuaj për miratimin në parim të kësaj marrëveshjeje mes qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Ky është një fond grant prej 5 milionë eurosh që qeveria gjermane nëpërmjet Bankës sa saj për Zhvillim vendos për të mbështetur fondin e garancive të kredive rurale, i cili synon rritjen e qëndrueshme të financimit të bizneseve mikro dhe të mesme në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit. Duhet të themi se vijmë nga një eksperiencë e mirë e këtij lloji financimi nga viti 2014 deri në vitin 2017 përmes financimit të BE-së prej rreth 3 milionë eurosh dhe është bërë i mundur disburimi rreth 1 mijë kredive në fushën e agrobiznesit të bujqësisë dhe të blegtorisë. Këto kredi u janë ofruar kryesisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke rritur në mënyrë të rëndësishme, të qenësishme zhvillimin e qëndrueshëm të tyre, rentabilitetin e këtyre ndërmarrjeve.

Ky financim, siç e thamë edhe më lart, është një garant nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Objektivi kryesor i këtij financimi është të rrisë numrin e institucioneve financiare pjesëmarrëse në këtë fond dhe të rrisë numrin e kredive të disbursuara në këto fusha. Mendojmë se me këtë financim shtesë sektorit bujqësor i vjen në ndihmë një mekanizëm shtesë për financimin e këtyre ndërmarrjeve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Halilaj!

Fjalën e ka kolegu Leka.

Edmond Leka- Faleminderit, zoti kryetar!

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë që po paraqitet do të ofrojë një kontribut shumë të rëndësishëm në promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë, duke garantuar kredi tregtare të institucioneve mikrofinanciare duke u dhënë mundësinë këtyre ndërmarrjeve për të qenë më konkurruese në treg. Hyrja në fuqi paraqet interes në aspektin ekonomik dhe social, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetje financiare dhe shtysa të mëtejshme në fushën e promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në Shqipëri dihet që këta të fundit janë ofruesit kryesorë të vendeve të punës dhe të rritjes ekonomike. Përdorimi i financimit në vlerën e 5 milionë eurove për zbatimin e projektit të promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancive të kredive rurale do të realizohet bazuar në kushtet dhe procedurat që do të përcaktohen nga kontratat që do të lidhen nëpërmjet KfW-së dhe marrësve të shumës së financimit.

Këto kontrata do t'u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Marrëveshja parashikon se premtimi i financimit do të zhvlerësohet në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri në përfundim të datës 31 dhjetor 2018.

Në aspektin ligjor dhe procedural ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Ftoj kolegët që ta miratojmë këtë marrëveshje.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Leka!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Fino. Pastaj zonja Hysi.

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Ne jemi përpara një drafti, të cilin duhet ta kalojmë. Kam një pyetje. Në fakt, ne kemi pasur një grant në vitet 2014-2017 rreth 3 milionë euro, 1 mijë kredi ju i keni dhënë. Do të doja të dija efektshmërinë pozitive ose edhe problemet negative që kanë ndodhur në këto vite me 3 milionëshin? Fakti që jepen 5 milionë tani, nuk e di se sa do të jenë kreditë e dhëna për fermerët, për promovimin e ndërmarrjeve të vogla, ato që janë të mesme, në rastin konkret në këtë që do të miratojmë sot. Nuk e kam në aspektin e rregullës së 3-shit, që me 3 milionë janë dhënë 1 mijë kredi dhe me 5 milionë mund të jepen më shumë, por e kam për efektshmërinë e tyre. Pra, ju na thatë se kanë kaluar rreth një mijë kredi. Sa është efektshmëria që ka ndodhur herën e parë? Nëse ka ndonjë gjë, që nuk na ka shkuar mirë, a mundet që me

këtë grant të dytë ne të rregullojmë apo të zgjidhim shumë probleme dhe një shpërndarje më efektive në të gjithë territorin e Shqipërisë të këtyre kredive?

Ilir Halilaj- Në lidhje me garantin e disbursuar në periudhën 2014-2017 ne kemi dhënë rreth 1080 kredi. Sipas analizave financiare që i janë bërë disbursimit të këtij fondi, norma e interesit është përmirësuar rreth 2-3%, sidomos për institucionet e mikrofinancës. Gjithashtu kemi pasur një rritje të kapitalit në dispozicion të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke i shërbyer mirë likuiditetit të këtij sektori. Problematikat kanë qenë sipas institucioneve financiare që e kanë përdorur këtë fond. Ky është një fond garancie që garanton kapitalin deri në 50% të kredive të institucioneve pjesëmarrëse në këtë fond. Bankat pjesëmarrëse si BKT-ja apo Credins, por edhe institucionet e mikrofinancës si NOA apo FED Invest-i kanë rritur në mënyrë progresive kapitalet ose numrin e kredive që kanë dhënë, duke u mbështetur te fondi rreth 3 milionësh. Në fondin prej 5 milionësh të tjera, ne mendojmë se do të disbursohen rreth 2 ose 3 mijë kredi më shumë, pra potenciali është deri në këtë pikë, por do të rritet edhe numri i pjesëmarrësve të institucioneve financiare që do të rrisë efektshmërinë e huadhënies në këtë sektor, duke e bërë më konkurrues dhe më të aksesueshëm ndaj fermerëve.

(Zoti Fino ndërhyr pa mikrofon)

Mendojmë 2-3 mijë. Kjo është në varësi të angazhimit që do të kenë institucionet e reja të mikrofinancës që do të marrin pjesën e fondit, por edhe të bankave të nivelit të dytë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Halilaj!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Kam një pyetje lidhur me atë që keni shkruar në relacionin që shoqëron këtë marrëveshje: “ Premtimi i shumës së përmendur, do të zhvlerësohet në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri në datën 31 dhjetor të vitit 2018”. Ne kemi qenë këtu në Kuvendin e Shqipërisë, ku për herë të parë kemi zhvlerësuar, kemi denoncuar disa marrëveshje dhe kemi rialokuar para në fushat përkatëse. Në vlerësimin tuaj kur sot është data 5 nëntor, ligji do të kalojë në seancë ditën e enjte, është dekretimi nga Presidenti, botimi në Fletoren Zyrtare, më pas 15 ditë për të hyrë në fuqi, juve ju kap fundi i vitit, a qëndron kjo që thoni në relacion? E keni thënë edhe në faqet 2 edhe 3, në rast se nuk lidhen kontratat përkatëse të financimit deri në 31 dhjetor 2018 premtimi i shumës zhvlerësohet. Kjo ishte e para.

E dyta, rimarr atë shqetësim që me të drejtë shumë herë e ngre zoti Fino, ju thatë se në grantin e parë të dhënë janë dhënë rreth 1 mijë kredi, tashmë ju mendoni 2-3 mijë kredi. Në këtë periudhë kaq të shkurtër kohore, si e keni menduar zbatimin e kësaj marrëveshjeje, që të jetë efiçiente dhe të shkojë, ashtu siç me të drejtë e thatë për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe paraja të përdoret në mënyrë efiçiente?

Ulsi Manja –Faleminderit!

Ilir Halilaj- Në lidhje me kohën e financimit, po, është e vërtetë, që ky 5 milionësh të garantohet nga qeveria gjermane duhet që ky projektakt të kalojë brenda vitit 2018. Ne besojmë se afatet kohore mund t'i arrijmë. Draftmarrëveshja me Bankën Gjermane për Zhvillim është gati dhe menjëherë pas dekretimit të këtij ligji, marrëveshja mund të lidhet. Synimi është brenda këtij viti dhe koha besojmë se është e mundshme për miratim.

Për periudhën e kreditimit, ky fond prej 5 milionësh në formë granti i vihet në dispozicion një organizate jofitimprurëse që është ngritur me qëllimin e menaxhimit të këtij fondi, që ka operuar që nga nëntori i vitit 2014. Institucionet pjesëmarrëse që do të angazhohen në këtë financim do të kenë kohën e mjaftueshme në vitet në vazhdim për të lidhur kontratat e tyre dhe për t'u aplikuar diligenca e duhur nga ana e fondit për menaxhimin e tyre nga bankat e nivelit të dytë ose institucionet e mikrofinancës.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Nëse ju kuptova drejt, shprehja që përdorni në relacion: “Kontratat përkatëse të financimit” nuk ka të bëjë konkretisht me kontratat që do të lidhen pas ratifikimit të marrëveshjes, e keni fjalën për marrëveshjet?

Ilir Halilaj - Po, vetëm për marrëveshjet.

Vasilika Hysi – Atëherë nuk është e saktë, sepse ju thoni: “Kontratat e financimit”. Nëse flasim për kontratat e financimit, duhet të saktësohet. Nëse është një kontratë me OJF-në, është në rregull, por po thatë “kontratat e financimit”, menjëherë del 2-3 mijë, që do të thotë se do të vini ta denonconi edhe këtë marrëveshje, pasi nuk keni mundësi t'i përdorni paratë.

Ulsi Manja- Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Zonja Hysi ka të drejtë, koha është e shkurtër dhe në qeveri e kanë kaluar, sipas relacionit më 17.10.2018, ndoshta duhet ta kalonim pak më shpejt, që të kishim edhe ne mundësinë, por duke menduar se në të gjithë muajin nëntor dhe fillimin e dhjetorit do të bëhen të gjitha këto procedura t'i jepet mundësia Ministrisë së Bujqësisë të bëjë kontratën me KfW-në, sepse nuk ka asnjë lloj mundësie dhe garancie që kontratat që bën vetë KfW-ja

apo edhe ministria e linjës me 2-3 mijë ndërmarrje të vogla, të mesme, kërkon me tepër kohë, natyrisht që do të aplikohet nga këto, pra mund të ketë edhe aplikime. Unë e mendoj si kontratë midis këtyre të dyve, por ajo që dua të them është se në relacionin tuaj duhet të jeni më të saktë kur thoni: “Tatimi mbi vlerën e shtuar, si edhe taksa dhe tatime të ngjashme indirekte”. Nuk mund të shprehemi kështu, por “taksat”. Taksat në tërësi cilat janë? Mbarten nga Këshilli i Ministrave. Pra, duhet të toni: “Që tatimi i vlerës së shtuar do të paguhet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë”. Taksat e tjera të veçanta konsumimi merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë. Krahë saj, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë përjashton KfW-në nga të gjitha llojet e taksave dhe tatimit publik. Juve duhet ta trajtoni saktësisht në program dhe në relacion. Cilën taksë u paguan të huajve qeveria apo ministria përkatëse nëpërmjet qeverisë? Vetëm TVSH-në apo taksat e tjera, me qëllim që kjo gjë të jetë e sanksionuar, të mos ketë nesër probleme. Nesër ai thotë: “Unë të kam sjellë lekët, ti m’i merr për taksa e të tjera”.

Ulsi Manja - Po, zoti Halilaj.

Ilir Halilaj - Në lidhje me trajtimin e taksave, ky është një përkufizim standard që kemi mes....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino - Më falni që ju ndërpres: taksat janë nga A-ja deri te Zh-ja. I ka miratuar parlamenti: taksa e vlerës së shtuar, taksa e kësaj, e asaj, pra janë disa lloje taksash. Ti duhet t’i përmendësh në relacion se nga cilat taksa e përjashtoni KfW-në, që të mos paguajë: një, dy, tre. Se këtë e vlerëson ti, taksën e përjashtuar, dhe thua: taksa të tjera të ngjashme. Po ju pyes: cilat janë taksat e tjera të ngjashme? Mund të më thoni? Nuk mund të thuash në relacion: taksa të tjera të ngjashme. Taksat janë të sanksionuara me ligj në parlament. Çdo taksë del nga parlamenti. Janë dhjetë, pesëmbëdhjetë, kushedi sa janë.

Tashti, ato taksa që s’i paguan KfW-ja, por qeveria shqiptare, nëpërmjet ministrisë tënde, se e ke të programuar në buxhetin afatmesëm, dhe jam i bindur se e ke të programuar, i thuaj këtu në relacion, që ta di.

Ulsi Manja – Zoti Fino, ndize mikrofonin, të lutem!

Bashkim Fino – S’ka problem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Halilaj.

Ilir Halilaj – Është i saktë komenti në lidhje me detajimin e taksave në rastin e tatimeve të ngjashme indirekte, sipas mënyrës që është shprehur në relacion, por duhet të themi se ky financim nuk është subjekt i asnjë takse nga ato që janë përmendur këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të japë përgjigje shteruese edhe ndonjë nga stafi që e shoqëron, i cili mund të jetë marrë me këtë gjë, nuk ka problem. Kush është marrë me këtë gjë.

Ilir Halilaj – Në fakt, duhet të themi se ky është një kusht, për t’u shprehur në mënyrë të tillë, nga ana e palës gjermane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, të mbarojmë me pyetjet. Ka ndokush tjetër pyetje? Nuk ka. Diskutime?

Zoti Fino, diskutim.

Bashkim Fino – Nuk kam ndonjë diskutim të madh. Është një projektligj që duhet kaluar. Unë kam bërë gjithmonë vërejtje korrektuese për ligje të kësaj natyre. E kam thënë dhe vazhdoj ta them, pavarësisht se nuk lodhem duke e thënë dhe nuk lodheni as ju duke e dëgjuar në procesverbal, se grantet nuk mund të kalojnë në parlament. Grantet janë grante dhe duhet t’i kalojë qeveria, vetë ministria përkatëse.

Është një grant që dikush dëshiron ta japë, të cilin t’i e përdor për programin që ke e të tjera. Unë e kam thënë përherë këtë gjë. ne, 140 deputetë, rëndohemi kot që të votojmë një grant të caktuar. Kemi votuar edhe grante 100 mijë euro, edhe 200 mijë euro, pavarësisht se kjo është shumë e konsiderueshme: 5 milionë euro.

Për s ai përket çështjes së fundit që diskutova, nga stafi i ministrisë dhe nga këshilltarët tanë do të kërkoja të saktësohej në relacion. Duhet të saktësohet në relacion, që ne të jemi të qartë, që edhe kur të shkojë te komisioni përgjegjës, të jetë e saktë se nga cilat taksa përjashtohet KfW-ja në rastin konkret të dhënie së këtij granti prej 5 milionësh. Nga taksa e vlerës së shtuar? Në rregull. Nga taksë tjetër, në qoftë se ka, të tokës a ku di unë çfarë mund të ketë? Nëse ka, duhet shënuar në relacion. Projektligji të bashkëngjitet me këtë relacion, dhe kur votojmë atje grantin 5 milionë, ndërkohë kemi miratuar në mënyrë indirekte, sepse është në relacion, zoti kryetar, edhe të gjitha heqjet e taksave për KfW-në gjermane, në rastin konkret të këtij granti.

Nuk mund të shënohet: “taksa dhe tatime të ngjashme indirekte”, sepse kjo është frazë e përgjithshme, gjë me të cilën nuk pajtohem. Unë nuk mund ta votoj këtë frazë të përgjithshme, sepse nesër në këtë frazë mund të përfshijë të gjitha llojet e taksave që mund të ketë Republika e Shqipërisë. Unë dua të jem i bindur për këtë, prandaj kërkoj që, deri sa të shkojë te komisioni

përgjegjës, ministria e linjës, së bashku me këshilltarët tanë, ta saktësojnë këtë paragraf, ta korrektojnë, ta rregullojnë ose të shënojnë të gjitha llojet e taksave që përjashtohen. Me kaq, problemi është i zgjidhur edhe nga pikëpamja e të shkruarit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit!

Unë e vlerësoj marrëveshjen që vjen, por kam një sugjerim, që ndoshta mund ta kem theksuar edhe më parë.

Në bazë edhe të angazhimit që ka marrë qeveria, ju keni detyrimin që në relacion të sqaroni me detaje përfituesit, impaktin që do të ketë kjo marrëveshje që do të ratifikohet në Kuvend, por edhe lidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe më shumë të dhëna e informacion, që çdo ministri ka. Relacionet nuk mund të jenë thjesht të thata, në lidhje me çfarë rregullon neni 1, 2, 3 apo 4, sepse ne i lexojmë vetë ato që thonë neni 1, 2, 3, 4 i9 marrëveshjes.

Ajo që na intereson është: cili do të jetë impakti në publik, ekonomik, financiar, social, mjedisor e të tjera? Pra, qeveria shqiptare merr ca angazhime, të cilat zbërthehen në nisma konkrete. Ky projektligj, që ne ratifikojmë, sikurse e thoni edhe ju vetë në relacion, në faqen 1 të relacionit. Në faqen 1 të relacionit thuhet se është në përputhje me programin e qeverisë. në cilën pikë? Cili është treguesi? Ne kemi ratifikuar edhe një rezolutë. Aty ka 17 objektiva. Me cilin objektiv përputhet? Kjo, që ne të dimë ta monitorojmë më pas, se sa eficient ka qenë përdorimi i 5 milionë eurove që jepen për ndërmarrjet e vogla e të mesme, por edhe se si janë përdorur 3 milionë eurot e mëparshme.

Ky është një sugjerim, të cilin duhet ta keni parasysh për të gjitha ligjet e tjera që do të sillni, pasi Kuvendi ka mbajtur një qëndrim, kështu që nuk do të ishte mirë që një marrëveshje të kthehej thjesht pse relacioni nuk është transparent dhe i detajuar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Për ta ndihmuar edhe diskutimin, edhe atë që thashë, edhe këtë. Përveç relacionit dhe ligjit, jam duke e lexuar dhe nënvizuar me kujdes marrëveshjen që është firmosur. Nuk e di kush e ka firmosur për Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 3 të marrëveshjes, siç është neni 3 ashtu e kanë shkruar edhe në relacion, thuhet: “Tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe taksa të tjera të ngjashme indirekte, që lidhen me këtë kontekst mbarten nga Këshillim i Ministrave të republikës së Shqipërisë.”

Kush e ka bërë këtë nen dhe e ka firmosur, nuk do të doja të thosha ndonjë fjalë të rëndë, por mund edhe ta them: është hajvan në kuptimin e plotë fjalës. Nuk mund të shkruash në një marrëveshje me palën tjetër, kushdo qofsh, përfaqësues i qeverisë ministër a zëvendësministër, ku të thuash: “taksat e tjera të ngjashme”. Jo more, jo. në nenin 3 thuhet të gjitha llojet e taksave, për të cilat ti, si qeveri shqiptare e si ministri, thua se do t’i marrësh përsipër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo këtu është shkruar gabim. Prandaj, meqenëse është shkruar gabim dhe është firmosur, dhe indirektë është firmosur gabim, duhet të plotësohet në relacion, përpara se ta votojmë, se cilat taksa përjashtohen: një, dy, tre ose asnjë. Jo kështu siç është shkruar në marrëveshjen e firmosur këtu.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, tani jemi në fazën e votimit.

Shumë faleminderit për sugjerimet, zoti Fino!

E hedhim për votim, në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Kush është dakord në parim?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet në parim!

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet neni 1!

Neni 2.

Neni 2. Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet neni 2!

Përpara se ta hedhim në votim, relatori, por edhe këshilltarja që ka punuar me projektligjin, së bashku edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, përpara se të firmoset relacioni i komisionit tonë për komisionin përgjegjës, të jenë evidentuar të gjitha sugjerimet e bëra nga kolegu Fino, por edhe nga kolegja Hysi.

Duhet të jetë e qartë, sepse para votimit në seancë plenare, ne do ta ndjekim edhe në seancë plenare raportin përfundimtar të komisionit përgjegjës, nëse janë reflektuar ose jo sugjerimet e bëra nga kolegu Fino, sugjerime të cilat u gjetën me vend edhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, të cilat, natyrisht, do të duhet të kihen parasysh në projekt-marrëveshjet e tjera që do të nënshkruhen.

Jemi dakord?

Kush është dakord, në tërësi me këtë projekt-marrëveshje, sipas sugjerimeve që u bënë? Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Ky projektligj, së bashku me relacionin përkatës, ku do të evidentohen qartësisht edhe sugjerimet e bëra nga kolegu Fino, t'i kalojë komisionit përgjegjës më as seancës plenare për votim.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Alma Mehmeti - Shefe e Sektorit Juridik

Silvana Dervishi - Përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, që është “Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Spartak Braho. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Brendshme: zonja Rovenà Voda, zëvendësministre, zonja Alma Mehmeti, shefe e sektorit juridik. Këtu kam të shkruar edhe zonjën Silvana Dervishi. Është paraqitur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë faleminderit për prezencën e sotme në komision. Shumë faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, si dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Jashtme.

Zonja Voda, do t’ju lutesha që, shkurtimisht, për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik, të bënit një prezantim të kësaj marrëveshjeje. Më pas fjalën do t’ia kaloj kolegut Spartak Braho.

Rovenà Voda – Mirëdita të gjithëve!

Ulsi Manja – Mund ta afroni pak mikrofonin, ju lutem!

Rovenà Voda – Mirëdita të gjithëve!

Memorandumi i mirëkuptimit, i cili kalon sot me këtë projektligj, në fakt do të thosha se shkon në një linjë me prioritetet e qeverisë shqiptare, por edhe me ato të Ministrisë së Brendshme, në luftën kundër veprave penale në fushën e drogave.

Në fakt, ka qenë një memorandum i firmosur me Komisionin European. Fillimisht me Ministrinë e Drejtësisë, për komponentët që i përkasin Ministrisë së Drejtësisë, kryesisht në bashkëpunimin gjyqësor e të tjera. Thelbi i këtij memorandum është ofrimi i një asistence financiare, në shumën 6 mijë euro për çdo vit, Ministrisë së Brendshme për komponentin D. Në fakt, komponenti D është komponent, i cili lidhet me politikat në fushën e veprave penale kundër drogës, kryesisht. Besoj se kjo është shumë e rëndësishme, sepse jemi edhe në fazën e procesit të *prescreening* për kapitullin 24, kapitull në kuadrin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, unë po flas për drogën. Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kush do ta prezantojë këtë marrëveshje? Zoti Armand?

Kush ka ardhur për marrëveshjen në lidhje me personat e zhdukur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rovena Voda – Më falni! Ju humba dhe kohën. Kujtova se ishte marrëveshja tjetër.

Ulsi Manja – S'ka problem! Rëndësi ka që jemi brenda së njëjtës ministri.

Rovena Voda – Po, brenda së njëjtës ministri jemi, patjetër.

Në fakt, marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur është një marrëveshje, e cila është e planifikuar në programin analitik të akteve të vitit 2018, në Ministrinë e Brendshme. Kjo marrëveshje synon intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur kryesisht gjatë periudhës komuniste, midis 29 nëntor 1944 dhe 2 korrikut të vitit 1991, por jo vetëm, dua at theksoje dhe këtë gjë. kemi lënë një hapësirë edhe për rastet e tjera, pra të personave të zhdukur mbas viteve nëntëdhjetë.

Sigurisht, përparësitë që priten të jenë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje lidhen me nevojën e gjetjes së personave të zhdukur, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin përmirësimin e shkëmbimit të informacionit në lidhje me këtë qëllim.

Mendoj se implementimi dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të ketë impakt. Mund të themi se për momentin, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur është e vetmja agjenci ndërkombëtare e specializuar, kryesisht me fokus veprimtarie gjetjen e personave të zhdukur. Nëse mund të bëjmë pak historik, fillimet i ka pasur që në vitin 1996, e krijuar me iniciativën e presidentit amerikan Bill Clinton, menjëherë pas luftës në Bosnjë-Hercegovinë, pra pas konfliktit të vitit 1990-1992.

Në fakt, Shqipëria është një ndër vendet e fundit të Ballkanit Perëndimor, që firmos këtë marrëveshje. Është një marrëveshje që ka pasur sukses në implementimin në vende, të cilat unë i përmenda, si Bosnje-Hercegovina, Kosova e vende të tjera.

Unë shpresoj se kjo marrëveshje, në një farë mënyre do të vërë në vend padrejtësinë e asaj kohe, duke mundësuar që familjarët të mund të gjejnë eshtrat e viktimave të asaj kohe. Por, e theksoj, jo vetëm. Në krye të kësaj marrëveshjeje kemi lënë një hapësirë edhe për raste të tjera, sepse edhe pas viteve '90 kemi persona të zhdukur për shkaqe nga më të ndryshmet, me qëllim që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit apo dhe prokuroria, të kenë mundësi që, nëpërmjet ekspertizës tepër të specializuar që ka kjo agjenci, ky komision ndërkombëtar, të mundemi të ofrojmë bashkëpunim dhe ndihmë për familjarët, për gjetjen e eshtrave të personave të zhdukur.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ministria e Jashtme.

Armand Skapi – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e tha edhe zëvendësministria, kjo është një marrëveshje e rëndësishme bashkëpunimi me komisionin për gjetjen e personave të zhdukur. Arsyeja kryesore se përse kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit është fakti se zyrës dhe personelit që do të punojë në Shqipëri, që faktikisht presupozohet të jetë vetëm një person, do t'i garantoni imunitet dhe privilegje në ushtrimin e funksioneve. Duke qenë se do të ketë shmangie nga legjislacioni, atëherë del e domosdoshme që marrëveshja t'i nënshtrohet ratifikimit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjala e ka zoti Braho.

Spartak Braho – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç u theksua edhe nga zonja zëvendësministre dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Jashtme, ky projektligj na vë në dijeni se qeveria shqiptare duhet të ratifikojë marrëveshjen e bashkëpunimit midis saj dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

Qëllimi i ratifikimit është fisnik dhe synon rritjen e përpjekjeve për gjetjen e eshtrave të personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste, por edhe më tej.

Sipas parashikimeve të marrëveshjes, ka modalitete që në lidhje me personat e zhdukur dhe ushtrimin e aktivitetit do të atashohet një person i veçantë, dhe në kërkim të personave të zhdukur do të përdoren metoda të posaçme tekniko-shkencore.

Vlerësoj se, parë në aspektin kushtetues, ligjor e procedural, por edhe të rëndësisë që ka vetë marrëveshja, ta miratojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Braho!

Ka pyetje nga kolegët?

Bashkim Fino – E para njëherë, kam përshtypjen se kjo marrëveshje vjen pak me vonesë, sepse duhej të qe bërë më shpejt. E tha mirë edhe zoti Braho, se kjo marrëveshje është fisnike, në kuptimin më të mirë të fjalës, ndaj duhej të ishte bërë më shpejt. E dyta, zëvendësministria tha se përkon me periudhën 29 nëntor 1945-korrik 1991, por besoj se njerëz të zhdukur kemi edhe pas 1991-shit. Kjo zyrë që do të krijohet në Tiranë, a do ta vazhdojë aktivitetin e vete dhe pas kësaj kohe, gjatë gjithë kësaj kohe? Sepse kjo është, siç tha përfaqësuesi i Ministrisë së Jashtme, thjesht për status diplomatik të atij që do të punojë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zonja Voda.

Rovena Voda – Faleminderit për pyetjen, zoti Fino!

Në fakt, unë e përmenda që në fillim, pavarësisht se ka qenë një iniciativë e nisur, unë dua të kthehem mbrapa në kohë. Ka qenë iniciativë e nisur dikur, shumë e vakët, që në vitin 2012, kur është bërë një tentativë për të krijuar një task- forcë brenda Ministrisë së Brendshme të drejtuar nga ish-zëvendësministri i asaj kohe, i cili, në bashkëpunim me ICMP-në, të fillonin procesin për gjetjen e eshtrave të viktimave të komunizmit, por nuk u bë asnjë gjë dhe mbeti po aty.

Në vitin 2014, për herë të parë, kemi nënshkrimin e një deklarate nga qeveria shqiptare bashkë me komisionin për personat e zhdukur. Qeveria shqiptare në atë kohë, me përfaqësues Ministrinë e Mirëqenies Sociale, mori përsipër detyrimin për të bashkëpunuar, pra, realisht, një angazhim serioz i qeverisë shqiptare për gjetjen e eshtrave që daton në vitin 2014 me deklaratën që u bë për të marrë përsipër dhe për të ruajtur standardin e të drejtave të njeriut, në njëfarë mënyre, për të vendosur të drejtën, duke lehtësuar edhe dhimbjen e atyre familjarëve të asaj kohë me gjetjen e eshtrave, u bënë përpjekje serioze.

Pati nisur dikur një lloj negocimi, nëse mund të them, me Autoritetin për Hapjen e Dosjeve, zonjën Sula, bashkë me Institutin e të Përndjekurve Politikë, por procesi u shty. Ne si Ministri e Brendshme vendosëm, duke pasur mbështetjen e qeverisë shqiptare, ta finalizojmë këtë marrëveshje (duke thënë se pse Shqipëria duhej të ishte një ndër vendet e fundit të Ballkanit Perëndimor që ta nënshkruante këtë marrëveshje), por besoj se ishte edhe koha, edhe ligji “Për hapjen e dosjeve”, pra me krijimin e Autoritetit, por edhe duke pasur vullnetin e qeverisë që të mund të përballemi edhe me kohën, me të shkuarën. Pra, mendoj se ky është edhe një lloj standardi.

Gjëja tjetër që ne vendosëm t’i lëmë hapësirë, dhe kthehem te pjesa ku ju, me të drejtë, tërhoqët vëmendjen, është se kemi persona të zhdukur edhe pas viteve ’90, ne e kemi lënë këtë hapësirë në marrëveshje, sepse Shqipëria ka ratifikuar edhe Konventën e Gjenevës për Personat e Zhdukur.

Zonja Hysi, me sa di unë, ka qenë tepër aktive te pjesa e respektimit të të drejtave të njeriut, pra edhe e një lloj përpjekjeje që duhet të bëjë qeveria shqiptare për gjetjen e personave të zhdukur, dhe unë besoj se kemi mundur që nëpërmjet disa marrëveshjeve të gjejmë këtë balancë. Pra, jo vetëm para viteve ’90, por duhet të shohim edhe këtë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

E falënderoj zonjën Voda për të gjitha përpjekjet që ka bërë me stafin e saj dhe me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, sepse kjo marrëveshje është nënshkruar publikisht më 18 korrik 2018, dhe erdhi në Kuvend.

Duke qenë se ne këtu në komision kemi tre nënkomisione, nënkomisionin për të drejtat e njeriut, nënkomisionin për organet e qeverisjes vendore, si dhe nënkomisionin që lidhet me administratën publike, unë do të doja të shprehja edhe vullnetin e Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të komisionit që unë drejtoj, doja të shprehja edhe besim se edhe nënkomisioni që drejton kolegu Fino, apo edhe nënkomisioni tjetër që drejton kolegu Hyseni do të jenë shumë aktivë për ta reale zbatimin e marrëveshjes.

Pse e them këtë? E them këtë se ka një shqetësim lidhur me koordinimin mes institucioneve dhe jo më larg se 2-3 ditë më parë kam pasur në zyrë përfaqësuesit e ICMP-së në një takim.

Unë do t'i kërkoja, zonjës Voda, që të merrte drejtimin dhe së bashku me institucionet të nxiste të gjithë punonjësit që kanë punuar në Ministrinë e Brendshme, që kanë informacion për vendndodhjen e varreve masive për të zbatuar dhe për të dhënë informacion te dy aplikacione që kanë filluar të vihen në zbatim nga muaji gusht për të bërë njoftime anonime për vendndodhjen e varreve të personave apo në aplikacionin tjetër online për të shkruar aty se kush ka informacion.

Gjithashtu, duhet kërkuar në arkivat që ju keni në Ministrinë e Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, apo nëpërmjet dosjeve që janë në Arkivin e Shtetit. Mendoj se Ministria e Brendshme duhet të ketë informacion, duhet të ketë arkiva dhe ajo pjesë e njerëzve që kanë shërbyer në atë kohë, që kanë informacion, që kanë qenë dëshmitarë, që kanë bërë punën e institucionit ku kanë punuar dhe që mund të jenë në pension, pra mund të ketë një mënyrë për t'i ftuar që të japin informacione dhe kjo është edhe njëfarë ndjese për atë çfarë mund të kenë bërë në atë kohë dhe kjo është një mënyrë e mirë për të zgjidhur këtë problem.

E them këtë sepse na ka ardhur një listë me 4000 persona që nuk gjenden. I kërkoj Kuvendit të Shqipërisë të angazhohet. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh edhe angazhimin e kolegut Fino në Nënkomisionin e Organeve të Qeverisjes Vendore, mendoj se të 61 kryetarët e bashkive, sidomos të atyre bashkive ku ka pasur kampe të punës së detyruar ose burgje të asaj kohe, para se të bëjnë zbatimin e planit rregullues vendor dhe t'u vënë kazmën mjediseve, të përcaktojnë se ku ka mundësi të ketë eshtra, me qëllim që të gjenden trupat e personave të zhdukur që të ketë edhe një pllakë përkujtimore dhe më pas le të vazhdojmë me zhvillimin e

planit vendor, por, të pakën, së pari, familjarëve t'u kthejmë eshtrat e personave që mund të jenë zhdukur në atë periudhë.

Nënkomisioni do ta ndjekë zbatimin e kësaj marrëveshjeje hap pas hapi.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Natyrisht që ndjekja e marrëveshjeve të tilla, të cilat i voton Kuvendi dhe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut, do të duhet të jetë pjesë e përditshme e punës së nënkomisionit përkatës dhe në rastin konkret të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, siç edhe pajtohem me sugjerimin tuaj se edhe me komisionin që drejton kolegu Hyseni, edhe me komisionin që drejton kolegu Fino do të duhet të rakordojmë axhendën për t'i konstituuar në mënyrë që puna e të tre nënkomisionëve të jetë në harmoni.

E hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Kush është dakord në parim?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet në parim kjo projekt marrëveshje.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Kjo projekt marrëveshje së bashku me relacionin përkatës t'i përcillet seancës plenare për votim.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nëpërmjet postës elektronike.

Faleminderit!

Ditë të mbarë dhe javë të mbarë të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

